



FINANCIAL AUDIT
AND ADVISORY

**Letra per Drejtimin e AIDSSH ne
lidhje me Projektin “Prokurimi i
rikonstruksionit të ndërtesës së
AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për
krijimin e një arkive modern”**

Date: 18/03/2021



Drejtuar: Drejtori i AIDSSH Znj. Gentiana Sula
Ne vemendje Sekretarit te Pergjithshem Z. Skender Vrioni; Kordinatorit Ms.
te: Mimoza Zeneli
Nga: E.S Financial Advisory shpk - Auditori Ligjor i pavarur
Date: 18/03/2021
Subjekt: Observimet e bazuara nga gjetjet pergjate auditimit Projektit per
periudhen Gusht 2019 deri me 31 Dhjetor 2020.

Kjo Leter per Drejtimin i shoqerohet dorezimit te raportit financiar te audituar nga Ne, per peridhen 9 Gusht 2019 deri me 31 Dhjetor 2020 sic kerkohet dhe ne termat e references per auditimin e Projektit.

Pikat e Observacioneve te trajtuara:

1. Mungesa e matrikullimit te formalizuar te Aseteve te prokuruar nga Autoriteti Implementues 3
2. Procedura e brendshme ne lidhje me dakordesine e Kordinatorit te projektit 3
3. Mungesa e fondit ne bashke-financim nga AIDSSH 4
4. Vonesa ne realizimin e shpenzimeve te buxhetuara te Projektit 5



1. Mungesa e matrikullimit te formalizuar te Aseteve te prokuruar nga Autoriteti Implementues

Observim

Bazuar ne auditimin tone dhe procedurat e kryera, konstatuam qe krahas punimeve kapitale per rindertimin e godines se re per AIDSSH e cila do te materializohet si aset perfundimtar pas momentit te perfundimit, per te gjitha blerjet e tjera qe perbejne asetet TIK (Teknologjia Informacionit dhe Komunikimit) dhe asetet te ngjashme to, raftet, kamerat etj, pavaresisht se jane perfshire ne nje liste Inventariale, nuk jane matrikuluar me nje kod unik te veçante per te mundesuar identifikimin e tyre qe nga momenti kur prokurohen deri ne perfundim te jetes se tyre. Matrikulimi mundeson kontrollin e gjithe aseteve materiale te lezishme, ne cdo moment deri ne prokurimin e fundit per asetet me fondet SIDA.

Risku/ Impakti

Mungesa e matrikullimit te asetve ndikon procesin e kontrollit te ketyre aseteve dhe mundesine e humbjes dhe/ ose pervesimit te tyre. Per me teper mungesa e nje Inventarizimi te tille te koduar sjell veshtiresi ne pasqyrimin e sakte dhe me vlere te plote te tyre ne kontabilitet, duke sjelle probleme ne raportim, per mbivenie te shumave ose keq- kategorizime te tyre.

Rekomandim

Pavaresisht se prokurimet e te mirave, punimeve dhe aseteve po behen ne vazhdimesi dhe zhvendosja e gjithe stafit te AIDSSH dhe aspektit material dhe dokumentar te institucionit do te behet pasi punimet ne godine te perfundojne dhe godina te kolaudohet, Rekomandojme fillimin e matrikullimit per te mundesuar nje identifikim te hershem te aseteve, kontrollin e plote dhe sigurine ne manaxhimin e plote te tyre, pavaresisht shperndarjeve dhe ri-shperndarjeve te mevonshme sipas departamenteve te Institucionit. Matrikulimi nuk eshte kerkese ligjore por eshte proces best practice qe eshte kryer nga Institucionet qe kane Inventar material te tille.

Pergjigja e Drejtimit

2. Procedura e brendshme ne lidhje me dakordesine e Kordinatorit te projektit

Observim

Sic u konstatua pergjate rishikimit te dokumentacionit te pagesave te kryera nga Projekti per te blerje te mirash, sherbime dhe Investime, ne praktikate e zgjedhura per testim auditimi, pagesa shoqerohej fatura e operatorit ekonomik, mandat pagesa, proces verbal per raste kur ka modalitet pagesash dhe autorizimi I firmosur nga Sekretari pergjithshem dhe Kordinatorja e Projektit.

Pjesemarrja e Kordinatorit ne kete praktike mbeshetet dhe ne Dokumentin Annex A - Propozim Projekti [seksioni i detyrave te Kordinatorit administrativ te projektit], gjithsesi detyra e kordinatorit eshte qe te kete informacion te plote mbi llogarite e projektit dhe procesin e prokurimeve dhe vleresimeve te tyre, pa te drejte vote. Deri



me tani Kordinatori eshte lajmeruar per proceset e tenderimeve dhe komisionet e ngritura per vleresimin e tyre, por ky lajmerim eshte bere ne menyre informale, gje qe nuk mundeson dokumentimin e pjesemarrjes, dhe kesaj marredhenieje te Kordinatorit ne proces tenderimi dhe vleresimi.

Risku/ Impakti

Risku mund te shprehet kur ne raste te procedurave te veshtira te prokurimit ku kemi te bejme me punime ne volum dhe vlere te medha, dhe pjesemarrsit operatore ekonomike mund te kene komente, verejtje dhe ankese, Kordinatori duhet formalisht te jete e njoftuar paraprakisht dhe te jete ne djene [ne koherence] te proceseve te meparshme prokuruese ku ka marre pjese dhe eshte ne djene te prokurimeve te tilla. Lajmerimi zyrtarisht i Kordinatorit per pjesemarrje ne proceset tenderuese jep garanci shtese sepse dokumenton angazhimin e Kordinatorit per saktesine, plotesine dhe garancine e procedurave te prokurimit dhe vleresimit te operatorit fitues per sherbimin, punen dhe/ose te mirat e prokuruar.

Rekomandim

Rekomandojme vendosjen e nje praktike te tille per formalizimin e perfshirjes se Kordinatorit sic pershkruar Annex - A Propozim projekti – Detyrat e Kordinatorit Administrativ. Si Plan veprimi Audituesi rekomandon pergatitjen e nje rregullorje te brendshme – 1 faqe me aspektet e perfshirjes se Kordinatorit ne perputhje me Annex A, dhe detajet e nevojshme orare, modalitetet e komunikimit psh me email ose shkrese zyrtare. Audituesi mund te ndihmoje ne ndertimin e nje dokumenti te tille.

Pergjigja e Drejtimit

3. Mungesa e fondit ne bashke-financim nga AIDSSH

Konstatim

Pergjate auditimit, konstatuam qe per Projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive modern” marreveshja e Grantit midis Suedise (nepermjet Programit SIDA) dhe AIDSSH parashikon ne piken 1.2 te saj (Seksioni Fusheveprimi dhe Sfondi) qe: *Fondi si bashkfinancim nga AIDSSH per projektin nuk eshte reflektuar ne buxhetin e qeverise, megjithate AIDSSH angazhohet te alokoje fondet e nevojshme ne buxhetin per kete projekt, dhe ta beje te disponueshme kete kontribut siç parashikohet ne projekt – Propozim (Annex A).*

Bazuar ne shkresen nr. 12184/3, date 26.07.2019 Ministria e Financave eshte ka shprehur dakordesi per miratimin e marreveshjes ndermjet Ambasades Suedeze dhe AIDSSH. Megjithate deri ne daten e raportimit ne kete auditim 31/12/2020, nuk asnje fond nga bashk-financimi.

Me 18/1/2021 Autoriteti implementues i Projektit ka marre nje Shkrese nga Ministria e Financave dhe Ekonomise e cila informon AIDSSH qe ne detajimin e



buxhetit per vitet 2021 – 2023, per shpenzime kapitale, jane buxhetuar Lek 11,000,000 si bashke-financim per kete projekt. Ky fond eshte bere disponibel ne thesar me 8/2/2021 ku dhe ka filluar likuidimi faturave.

Impakti

Pavaresisht dakordesise nga Ministria Financave per kete marreveshje, pjesemarrja e hershme me bashke-financim do te mundesonte mese miri mbeshtjetja me fonde per aktivitetet e prokurimit dhe realizimin e Investimeve. Kontributi i njekohshem i dyanshem do re respektonte mese miri Marreveshjen e Grantit ne te gjitha pikat e saj per gjithe periudhen 17 mujore te realizimit te aktiviteteteve (sipas Annex B i projektit) deri me 31/12/2020.

Rekomandim

Eshte gje positive qe me ne fund fondi bashke-financimit eshte bere disponibel nga data 8/2/2021. Sic u bisedua dhe me personat perfaqesues te projektit dhe Institucionit, rekomandojme vazhdimesine e likuidimit te faturave te prapambetura duke perdorur tashme dhe fondin e qeverise te miratuar dhe te ezaurojne sa me efektivisht gjithe zerat e Investimeve, te mirave dhe sherbimeve sipas buxhetit dhe skedulit kohor te dakordesuar.

4. Vonesa ne realizimin e shpenzimeve te buxhetuara te Projektit

Konstatim

Bazuar ne procedurat e auditimit te kryera nga Ne per shpenzimet ndermarra te Projektit "*Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive modern*" veme re qe nga momenti i miratimit te projektit dhe mberritja e fondeve, Autoriteti implementues AIDSSH ka shpenzuar rreth 14% ne total te zerave te buxhetit te financuar nga SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency), per nje periudhe 1 vjeçare qe nga momenti I marrjes se fondeve ne llogarine bankare ne Credins Bank (17/12/2019). Pavaresisht se Institucioni ka bere perpjekjet per te celur llogarite (ne 2 nivelet bankare) per thitjen e fondeve dhe administrimin e tyre, absorbimi i fondeve ka rezultuar me vonese duke marre parasysh daten e celjes se llogarive 19/09/2019 dhe marrjen perfundimtare te tyre me date 17/12/2019. Ne lidhje me aktivitetet e tjera te Projektit qe nga prokurimi deri ne zhvillimin faktik te veprimtarive ka pasur vonesa, te arsyeshme te shkaktuara sado pak nga Termeti ne Nentor 2019 por dhe nga efekti i pandemise Covid – 19 qe ka peshen me te madhe te ndikimit ne aktivitetet e prokuruar, te kontraktuara dhe zhvilluara nga AIDSSH.

Impakti

Ne situatë normale nga proceset e absorbimit te fondeve deri ne zhvillimin e prokurimeve dhe realizimin e punimeve sipas skeduleve normale, realizimi do te ishte me i larte sidomos ne zerat me substanciale te Buxhetit te projektit, duke raporruar nje ecuri te pergjithshme edhe me te larte te veprimtarive.



FINANCIAL AUDIT
AND ADVISORY

Rekomandim

Pavaresisht se situata e pandemise vazhdon por me kufizime qe nuk ndikojne ne oraret e punes dhe biznesit qe ka lidhje me kete projekt, sic u diskutua me personat perfaqesues te projektit dhe Institucionit, rekomandojme qe te kihet focus nje ecuri me dinamike [psh; kordinim sa me i mire i punes per te shkurtuar afatet e prokurimeve, sigurisht ne respektim te normave ligjore] per te zhvilluar dhe ezauruar sa me shume punimet, sherbimet dhe te mirat e planifikuara per kete projekt dhe zhvendosjen e suksesshme ne godinen e re brenda afateve te dakordesuar sipas marreveshjes se Grantit dhe komunikimeve me donatorin per realizimin e plote.

Pergjigja e Drejtimit





RAPORTI I "MARRËVESHJEVE TË RËNA DAKORD MBI PROCEDURAT" BAZUAR NË TERMAT E REFERENCËS SË PROJEKTIT "Financimi i drejtpërdrejtë i AIDSSH për prokurimin e rindërtimit të ndërtesës së autoritetit dhe shërbimeve të TIK për krijimin e një arkivi të integruar dhe modern"

Për: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)

Adresa: Garda e Republikës së Shqipërisë, Rruga Ibrahim Rugova

Qëllimi i raportit të "Marrëveshjeve të Rëna Dakord mbi Procedurat"

Raporti ynë ka të bëjë vetëm me qëllimin për të ndihmuar Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (aty pas AIDSSH) në përcaktimin se detyrat, të cilësuar si të detyrueshme dhe të rëndësishme, rënë dakord sipas Termavë të Referencës mbi Auditimin Vjetor të Projektit "Financimi i Drejtpërdrejtë AIDSSH për prokurim të Rindërtimit të Ndërtiesës së Autoritetit dhe shërbimeve të TIK për krijimin e një arkivi të integruar dhe modern", janë kryer në mënyrë korrekte dhe mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër.

Përgjegjësitë e Palëve të Angazhuara

AIDSSH, ka pranuar që procedurat e dakorduara ndiqen në përputhje me Termat e Referencës mbi Auditimin Vjetor të Projektit për qëllimin e angazhimit.

E.S Financial Advisory sh.p.k. siç identifikohet nga AIDSSH, është përgjegjës për temën mbi të cilën kryhen procedurat e rëna dakord.

Përgjegjësitë e praktikuesit

Ne kemi kryer procedurat e rëna dakord në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Shërbimet e Lidhura (ISRS) 4400 (i Rishikuar), Angazhimet e Rëna dakord mbi Procedurat. Një angazhim i procedurave të dakorduara përfshin kryerjen tonë të procedurave dhe raportimin e gjetjeve, të cilat janë rezultatet faktike të procedurave të rëna dakord, të kryera. Ne nuk bëjmë asnjë përfaqësim në lidhje me përshtatshmërinë e procedurave të rëna dakord.

Ky angazhim mbi procedurat e rëna dakord nuk është një angazhim sigurie. Në përputhje me rrethanat, ne nuk shprehim një mendim ose një përfundim sigurie.

Nëse do të kishim kryer procedura shtesë, çështje të tjera mund të kishin ardhur në vëmendjen tonë që do të raportoheshin.

Etika Profesionale dhe Kontrolli i Cilësisë

Ne kemi përmbushur kërkesat etike në Kodin e Etikës së Kontabilistëve për Bordin e Standardeve të Etikës Ndërkombëtare për Kontabilistët (Kodi IESBA) dhe Kodin e Etikës së Institutit të Auditorëve të Çertifikuar të Autorizuar të Shqipërisë (Kodi IEKA). Për qëllimet e këtij angazhimi, nuk ka kërkesa për pavarësi, të cilat neve na kërkohet të respektojmë.

Firma jonë zbaton Standardin Ndërkombëtar të Kontrollit të Cilësisë (ISQC) 1, Kontrollin e Cilësisë për Firmat që Kryen Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare dhe Angazhime të Sigurimeve të Tjera dhe Shërbimeve të Ndërlidhura, dhe në përputhje me rrethanat, mban një sistem gjithëpërfshirës të



kontrollit të cilësisë duke përfshirë politikat dhe procedurat e dokumentuara në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat etike, standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Procedurat dhe gjetjet

Ne kemi kryer procedurat e përshkruara më poshtë, të cilat janë përshkruar në Termat e Referencës për Auditimin Vjetor të projektit.

	Procedura	Gjetje
1	Ndiqni nëse kostot e pagave të debituar në projekt / program regjistrohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit në një mënyrë të sistemuar dhe ekzaminoni nëse kostot e pagës mund të verifikohen me dokumentacion të mjaftueshëm mbështetës.	Ne kemi marrë nga Autoriteti Zbatues të gjitha listat e pagave të stafit për muajt nën auditim dhe kemi verifikuar që llogaritja e tarifave të sigurimeve shoqërore, tatimi mbi të ardhurat dhe regjistrimet përkatëse të kontabilitetit janë bërë në mënyrë korrekte. Mostra e zgjedhur ishte 88% e të gjitha listave të pagave mujore. <i>Nuk kishte gjetje faktike.</i>
2	Kontrolloni nëse raporti financiar përfshin një krahasim, për çdo zë të buxhetit, midis kostove / shpenzimeve aktuale të aktiviteteve dhe kostove / shpenzimeve të buxhetuara siç është aprovuar nga SIDA për periudhën.	Si pjesë e procedurave tona, ne kemi marrë dhe krahasuar raportin e përgatitur nga koordinatori i projektit me oficerin financiar të Institucionit, me buxhetin, raportin përfundimtar financiar të audituar. <i>Gjetjet tona faktike ishin më poshtë:</i> <ul style="list-style-type: none">• Raporti i përgatitur nga koordinatori i projektit ka një afat kohor Gusht '19 - Korrik '20, por kronologjia e audituar e raportit përfundimtar është Gusht '19 - Dhjetor '20 sepse përmbante periudhën e plotë dhe përputhet me vitin zyrtar financiar.• Zyrtari financiar i Institucionit përgatiti një raport shumë të veçantë mujor në përputhje me një format strikt qeveritar (ky është një raport thesari monitorimi jo për qëllime raportimi të lidhura me projektin), por shifrat në këto raporte janë të njëjta me ato të raportuara në raportin e Koordinatorit.• Ekziston një buxhet i krahasueshëm me atë aktual në këto raporte, si dhe në raportin përfundimtar të audituar. <i>Këto gjetje nuk paraqesin domosdoshmëri për rregullim por janë vetëm shpjeguese.</i>
3	Bazuar në materialitetin dhe rrezikun, auditori do të shqyrtojë nëse ka dokumentacion mbështetës në lidhje me kostot e bëra. Pavarësisht nga materialiteti i gjetjeve, auditori do të përcaktojë sasinë e shumës për kostot që nuk kanë	Bazuar në procedurat tona, ne kemi zgjedhur të gjitha klasat e transaksioneve të ndodhura për periudhën nën auditim. Nuk kishte gjetje faktike në lidhje me mungesën e dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës. Ne kemi zgjedhur mbi 80% të të gjitha transaksioneve.



	dokumentacion të mjaftueshëm mbështetës.	
4	Kontrolloni nëse fitimet / humbjet në valutë të huaj shpallen si një zë i veçantë në raportin financiar, si dhe shpallen në përputhje me atë që përcaktohet në marrëveshje, përfshirë shtojcat dhe parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit.	Ka vetëm një humbje nga këmbimi të ndodhur brenda kësaj periudhe, kur fondet e disbursuara nga SIDA [8,000,000 SEK] janë përkthyer në depozitë në EUR dhe më pas bëhen të disponueshme në lekë në bankën e nivelit të dytë. Nga ky transaksion është bërë një humbje e barabartë me 200,045 SEK [7,799,955 SEK ishin fondet në dispozicion]. Ne kontrolluam 100% të fondeve hyrëse dhe verifikuam ciklin e tyre.
5	Pajtueshmëria e partnerit të bashkëpunimit me legjislacionin e zbatueshëm tatimor në lidhje me taksat (p.sh. PAYE) dhe tarifat e sigurimeve shoqërore.	Bazuar në procedurat tona të auditimit, sigurimet dhe TAP (tatimi mbi të ardhurat personale) u mbajtën në përputhje me rrethanat, siç parashikohet nga ligji për të gjitha listat e pagave që kemi kontrolluar. <i>Nuk kishte gjetje faktike në lidhje me këtë pikë.</i>
6	Ndiqni nëse partneri i bashkëpunimit ka respektuar udhëzimet e prokurimit të aneksuara ose referuar në marrëveshje.	Ne kemi kontrolluar prokurimet e zgjedhura (rreth 100% e prokurimeve të disbursuara brenda periudhës dhe të aprovuara brenda kësaj periudhe). Të gjitha prokurimet janë bërë në bazë të ligjit nr. 9643 "Për prokurimin publik" Neni 30, datë 20 nëntor 2006. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Lidhur me miratimin e rregullave të prokurimit". <i>Nuk kishte gjetje faktike në lidhje me këtë pikë.</i>
7	Rishikoni nëse bilanca dalëse për periudhën e mëparshme është e njëjtë me bilancën hyrëse për periudhën aktuale.	Meqenëse ky ishte auditimi i parë, nuk ka balancë hapëse për këtë angazhim.

Firma
18/03/2021

E.S Financial Advisory sh.p.k.
Adr: Rr" Tefta Tashko Koco"
Pall. 132. Hyrja 1, Tirane

